

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Mihrie Krasniqi-Sheholli dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbonë Fejza, në çështjen penale kundër të akuzuarve I.A. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe M. N. për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4551/17 të dt.22.03.2018, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur më dt.01.04.2019 në praninë e Prokurorit të Shtetit Rexhep Maqedonci, të dëmtuarës F.P., mbrojtësit të viktimave A.P., të akuzuarit I.A. dhe të akuzuarës M.N. me mbrojtësin e saj të autorizuar av.B.S. nga P., të njejtën ditë në prezencë të mbrojtësit të akuzuarës mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10.04.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit,

I.A. nga i ati R. dhe nëna S., mbiemri i vajzërisë së nënës A., i lindur më datë *data e lindjes...*, me vendbanim në P., B. i D.-B. e I., Ll. 2 kati II nr.2, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, teknik medicinale në QKUK-P., i martuar-baba i 1 fëmijë, i gjendjes së dobët ekonomike-sociale, sipas evidencës penale të kësaj gjykate nuk ka qenë i dënues më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar – Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

M.N. nga i ati R. dhe nëna S., mbiemri i vajzërisë së nënës A., i lindur më datë *data e lindjes...*, me vendbanim në fshatin G., Komuna e P., me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e martuar, e gjendjes së dobët ekonomike-sociale, sipas evidencës penale të kësaj gjykate nuk ka qenë e dënues më parë dhe ndaj saj nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar – Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R Ë

S e p s e :

I akuzuari I.A.

Me dt.24.07.2017, rreth orës 13:00, në shtëpinë e tij e cila gjendet në fshatin G., Komuna e P. për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme që ka pasur me bashkëshorten e tij-tani të dëmtuarën F.P., ditën kritike me dashje që t'i shkaktoj lëndime trupore e ka sulmuar fizikisht të njejtën fillimisht e ka kapur për fyti, pastaj e ka goditur me shuplaka në fytyrë, me ç'rast e dëmtuara ka pësuar lëndime të lehta trupore si ndryshje të indeve të buta, me gërvishtje në të dy anët e qafës me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

E akuzuara M.N.

Me datë, kohë dhe vend të njejtë të përshkruar si në dispozitivin I të kësaj aktakuze për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme që ka pasur me kunatën e saj-tani të dëmtuarën F.P., e pandehura M.N., ditën kritike me dashje ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarës, ashtu që të njejtën e ka kapur për flokësh.

Me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 187 dhe 188 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 369, 370, 450, 453, 463 të KPPRK-së, i:

G J Y K O N

Të akuzuarin **I.A.** me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale, nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të akuzuarën **M.N.** me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda afatit prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale, nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Detyrohet i akuzuari I.A. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ekspertizës Mjeko-Ligjore të paguaj shumën prej 20 €uro (njëzet/€uro) ndërsa dy të akuzuarit secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë/€uro) dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë/€uro), të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

E dëmtuara F.P. me vendbanim në P., B. i D.-B.e I., Llam 2 kati II nr.2, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregull juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm ka ushtruar aktakuzën, PP.II.nr.4551/17 të dt.22.03.2018, kundër të akuzuarve I.A. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe M.N. për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 29.01.2019, gjatë të cilës prezantuan Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të akuzuarit dhe mbrojtësi av.B.S. nga P.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar, i akuzuari I.A. e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë duke deklaruar se pendohej, ndej keqardhje, me bashkëshorten tani jetojmë në harmoni familjare, i kemi tejkaluar të gjitha problemet, kërkoj nga gjykata një dënim sa më të butë ndërsa e akuzuara M.N. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata pas pranimit të fajësisë, vërtetoi se akuzuari I.A. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet dhe provat e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e njejta është në përputhje me shkresat e lëndës dhe dispozitën e nenit 248 të KPPRK-së.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtim fillestar, andaj shpalljen e aktgjykimit e bëri pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor për të akuzuarën M.N.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor sa i përket të akuzuarës M.N. për veprën penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, me datë 01.04.2019 në të cilën ka prezentuar Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, e dëmtuara-F.P., dëshmitarja S.A., mbrojtësi i viktimave A.P., të akuzuarit I.A. dhe M.N. me mbrojtësin e saj të autorizuar av.B.S.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se: Konsideroj që deklaratën e të pandehurës M., gjykata nuk duhet t'ia falë besimin ngase nuk është bindëse dhe është në kundërshtim të plotë me deklaratën e të dëmtuarës dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me një mbrojtje të tillë e pandehura mundohet t'i ikë përgjegjësisë penale, andaj duke i analizuar shkresat e lëndës dhe duke i ndërlidhur në kontest logjik dhe faktik me njëra tjetrën vijmë në përfundim se në rastin konkret në veprimet e të pandehurës qëndrojnë të gjitha tiparet e veprës penale Sulmi të përshkruar si në dispozitivin II të aktakuzës, andaj kërkoj nga gjykata që të pandehurën ta shpall fajtores dhe ta dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i viktimave A.P. në fjalën përfundimtare deklaroi: I bashkangjitet aktakuzës ndaj të pandehurës M.N., pasi që gjatë seancës së sotme e njejta ka dhënë deklaratë kundërtënëse dhe jo në përputhje me deklaratat e mëparshme, provat dhe deklarata e palës së dëmtuar F.P. e vërteton se e pandehura ditën kritike e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, sa i përket dëshmisë së dëshmitares S.A. janë gjithashtu kundërtënëse dhe jo të sakta, andaj kërkojmë nga gjykata që e pandehura të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

E dëmtuara-F.P. në fjalën përfundimtare theksoi se e mbështes fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të viktimave dhe parashtroj kërkesë pasurore-juridike vetëm sa i përket kunitës mirëpo nuk mund ta precizoj saktësisht.

Mbrojtësi i të akuzuarës av. B.S. në fjalën përfundimtare deklaroi: Meqenëse gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk arriti të vërtetohet gjendja faktike sa i përket të pandehurës M., gjendje kjo e cila me asnjë provë të vetme nuk arriti që të vërtetohet përpos një deklarate nga pala e dëmtuar e cila është në kundërshtim kontradiktor me vet deklaratën e palës së dëmtuar dhënë në polici me dt.24.07.2017 ku për më tepër e citoj se në rreshtin e katërt-pestë: “ por vjehrra ime S.A. i doli përpara dhe nuk e la të më sulmonte” pastaj edhe në rreshtin e 15-të të po asaj deklarate përshkruhet e njejta gjendje ku citoj:” ndërsa vjehrra ime S.A. duke u munduar që ta ndalte konfliktin mi ka kapur të dy duart ndërsa unë duke u vetmbrojtur e kam shtyrë dhe ajo është rrëzuar” ndërsa në deklarinim e dhënë sot gjatë shqyrtimit gjyqësor e njejta thotë se po ashtu ka qenë e sulmuar nga vjehrra e saj, deklarimi i saj është kontradiktor dhe i propozoj gjykatës që mos ti falet besimi se nuk është e mbështetur në asnjë provë materiale ndërsa tua falë besimin deklaratës së të mbrojturës time dhe deklaratës së dëshmitares dhënë në shqyrtim gjyqësor. I propozon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit e mbrojtura ime M.N. të lirohet në tërësi nga aktakuza në mungesë të provave.

E akuzuara M.N. në seancën e shqyrtimit gjyqësor veç të tjerash deklaroi: Ditën kritike ne kemi pasur vetëm fjalosje me F. dhe nuk ka pasur kurfarë sulmesh, mes meje dhe saj nuk ka pasur sulm dhe nuk është e vërtetë që unë e kam kapur për flokësh.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor: nga deklarata e të dëmtuarës-dëshmitares F.P. dhe dëshmitares S.A. dhe pjesërisht edhe nga vet deklarata e të akuzuarës.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale, gjykata konform nenit 8 par.1 dhe 2, si dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

E dëmtuara –dëshmitarja F.P. në seancën e shqyrtimit gjyqësor veç të tjerash deklaroi: Ditën kritike vjehrra më kërkoi që të shkojmë te kunati i vet për të nderjt për qef, shkuam por meqenëse nuk ishte askush u kthyem, kur u kthyem në shtëpi M. e pyeti nënën e vet pse u kthyet, nëna e vet i tha se u kthyem pasi nuk ishte askush aty, atëherë M. i tha nënës së vet :”Normal se nuk u’a hap askush derën sepse kjo është e paedukatë”, në atë moment e njejta i kishte telat në dorë dhe mi gjuajti në trup e që unë isha me djalin në dorë, hyra brenda dhe e njejta me fjalë fyese vazhdoi që të më ofendoj, kur e pash se kjo vazhdimisht insistojke me më sulmu dola në korridor dhe i tregova vjehrrit, ai më tha normal që të sulmon se kjo është në shtëpi të vet, kur e pash që nuk gjeta përkrahje nga askush e mora djalin shkova në dhomë, bisedova me prindërit e mijë me telefon, kur erdhi burri nga puna ma mori djalin e lëshoi në beshik-djep dhe më ka kapur për fyti ndërsa vjehrra i thoshte mbythe krejt se kjo po na sjell shumë telashe, në ato momente unë jam larguar dhe kam tentuar ta marr telefonin dhe ta njoftoj policinë dhe në ato momente M. më ka kapur për flokësh dhe kur mi ka lëshuar flokët arrita ta njoftoj policinë, qëndroj mrapa deklaratës së dhënë në polici, kam qenë e sulmuar nga 5 anëtarët e familjes-kunatat A. dhe M., vjehrrit S. dhe R., po atë ditë kam pësuar lëndime trupore në qafë, kam pasur gërvishitje, dëmtime të unazave të qafës C1 dhe jam detyruar të mbaj qafore 1 muaj, në atë kohë e kam pasur fëmijun 4 muajsh, kam kërkuar edhe urdhër-mbrojtje nga gjykata ndaj gjithë anëtarëve të familjes por për hirë të djalit tim jam bërë kurban dhe jam kthyer prap në atë shtëpi mirëpo edhe pasi jam kthyer kam pasur dhunë fizike dhe psiçike.

Dëshmitarja S.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor veç të tjerash deklaroi: Ditën kritike F. dhe M. janë fjalosur por asnjëra tjetrës nuk i ka ra, në momentin kur janë fjalosur kemi qenë në oborr pastaj kemi hyrë brenda, unë kam hyrë në mes të tyre e kam larguar M.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi, pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor e vërtetoi gjendjen faktike se e akuzuara M. për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme me kunatën e saj-tani të dëmtuarën F., me dashje ka përdorur forcën ndaj saj ashtu që të njejtën e ka kapur për flokësh.

Është jo kontestuese se ndërmjet të akuzuarës dhe të dëmtuarës ka ekzistuar një mosmarrëveshje-fjalosje ditën kritike ndërsa ishte kontestuese se e pandehura M.N. a e kishte sulmuar të dëmtuarën.

Gjykata në mënyrë të hollësishme analizoi mbrojtjen e të akuzuarës duke e hedhur poshtë si të pabazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe duke e vlerësuar si përpjekjeje për ti ikur përgjegjësisë penale për shkak se është në kundërshtim të plotë me deklaratën e të dëmtuarës.

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke i dhënë besimin e plotë deklaratës së të dëmtuarës-dëshmitares se e pandehura ditën kritike, me dashje kishte përdorur forcën dhe e kishte kapur për flokësh nga mrapa.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarve, kështu që të njejtë janë penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit I.A. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe me veprimet inkriminuese të të akuzuarës M.N. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, për të cilat vepra penale gjykata të njejtë i shpalli fajtor dhe i dënoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese për të akuzuarin I.A. gjeti faktin se i njejtë në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, nuk ka qenë i gjykuar më parë, i ka kërkuar falje të dëmtuarës-bashkëshortes së tij, i njejtë është penduar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë të përgjegjësisë penale pasi që i njejtë veprën e ka kryer me dashje, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që është integriteti dhe trupi i njeriut ndërsa sa i përket të akuzuarës M.N. si rrethana lehtësuese gjykata gjeti se nuk ka qenë e gjykuar më parë ndërsa si rrethanë veqanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Prandaj gjykata duke i vlerësuar këto rrethana ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të

mbrojtura, rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tyre, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së. Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë është marr në kuptim të nenit 47 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u morr në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 dhe 3 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nënpar 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.273/2018 me dt.10.04.2019**

**Zyrtare Ligjore
Mihrie Krasniqi-Sheholli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.